

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

ANKESË

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: ORGANI SHQYRUES I PROKURIMIT PUBLIK

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	62500-21-6982-5-2-1
Nr i brendshëm	62500-21-122-521

Sa i përket tenderit për

**ASFALLTIMI I RRUGËVE NË FSHATRA TË JANQIST, LLADROC, MAXHARRË,
MARALI, SHKARASHNIK, TËRPEZË E ULËT DHË NË QYTEZËN E MALISHEVËS**
Ankesa kunder A.K. : KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

„FLAMURI V” SHPK (në konzorcium me N.T., „Flamuri” , „Benita Company”)

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

MALISHEVE

(Adresa)

MALISHEVE
(Vendi)

24000
(Kodi postar)

0038349244487
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)


Z. VLLAZNIM MAZREKU

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

flamurivshpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

22.03.2022

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1. Njoftimi për Kontratë: 18.10.2021
2. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 27.10.2021
3. Kerkese per zgjatje te afatit të vlefshërisë 06.01.2022
4. Vendimi nga A.K. për Anulimin B58 me date 14.03.2022
5. Vendimi mbi Refuzimin e Kerkeses per Rishqyrtim data 18.03.2022

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 pika 1 i LPP-së
Neni 7 pika 1 i LPP-së
Neni 51 , njoftim i kriterëve të perzgjedhjes
Neni 59 , Egzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tendereve, paragrafi 4
Neni 60 , Kriteret për dhenjen e kontrates
Neni 62 , Perfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
Neni 69 i LPP-së
Neni 31.4 të RRUOPP-së

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

1. Nuk është respektuar Neni 1 pika 1 e LPP-së (Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike).
2. Nuk është respektuar Neni 7 pika 1 i LPP-së (Barazia dhe Trajtimi, Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente), dhe
3. Nuk është respektuar Neni 69, Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
4. Nuk është respektuar Neni 59 paragrafi 4 të LPP-së
5. Nuk është respektuar Neni 31.4 të RRUOPP-së

Dhe të gjitha Nenet e sipërpermendura të ligjit të prokurimit.

Të nderuar, Autoriteti Kontraktues, me datë 14.03.2022 ka publikuar Njoftimin B58 Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për Anulimin e Aktivitetit, kurse me datë 18.03.2022 ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim të konzorciumit tonë për tenderin me titull **ASFALLTIMI I RRUGËVE NË FSHATRA TË JANQIST, LLADROC, MAXHARRË, MARALI, SHKARASHNIK, TËRPEZË E ULËT DHË NË QYTEZËN E MALISHEVËS**

Me të cilin njoftim Autoriteti Kontraktues Komuna e Malisheves Anulon Aktivitetin e Prokurimit , ku edhe Konzorciumin tonë („Flamuri V” shpk ,

N.T., „Flamuri” , „Benita Company” shpk) e ka shpall si të papërgjegjëm me arsyetime komplet absurde dhe jo të bazuara në kërkesat e FDT tek kërkesat e tenderit dhe A.K. ka shkelur Ligjin e Prokurimit nenet e përmendura më lartë. Ne kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtimin e Vendimit të A.K. e cila kërkesë me datë 18.03.2022 është refuzuar nga Komuna e Malishevës pa kurrfarë sqarime shtesë pse kërkesa jonë është e pabazuar.

**ARSYEJA QË A.K. KONZORCIUMIN TONË („Flamuri V” shpk ,
N.T., „Flamuri” , „Benita Company” shpk) E KA SHPALLUR TË
PAPËRGJEGJËM ËSHTË :**

Asyeja sipas A.K. : Menagjerit të projektit i caktuar nga OE i mungon pervoja e punes 5 vite mbas diplomimit.

Ky Arsytim nga A.K. nuk është i bazuar fare në kriteret e dosjes së tenderit , kjo që inxhinjeri duhet të ketë pesë vite përvojë pune mbas diplomimit .

Në dosjen e tenderit për inxhinjerin kërkohet siq vijon:

5.OE duhet të dëshmojë se ka autorizuar një inxhinjer të diplomuar ose master Drejtimi Infrastruktura Rrugore - Menaxheri i Projektit kërkohet të ketë min. 5 vite përvojë pune –angazhime profesionale mbas diplomimit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

d.Inxhinjeri Duhet të posedojë diplomën e noterizuar, të ketë kontratë ose parakontratë ku specifikohet qartë angazhimi për këtë projekt. CV-ja e përshkruar qartë me eksperiencën e kërkuar, e nënshkruar.

Sqarim : Inxhinjeri i Diplomuar i Infrastrukture rrugore që ne kemi marrëveshje për angazhimin e tij në këtë projekt ka përvojë pune në menagjimin e projekteve infrastrukturore të pakten 15 vite pas diplomimit si bachelor i ndërtimtarisë, i diplomuar në fushën e ndërtimtarisë që nga viti 2006 , dhe i angazhuar në menagjimin e shumë projekte të mëdha infrastrukturore në Republikën e Kosovës, e që nga data 21.06.2021 është i kualifikuar edhe si Master në Infrastruktura rrugore. Pra Inxhinjeri i angazhuar ka perva te mjaftueshme ne menagjimin e projekteve rrugore, ju lusim qe kjo qeshtje të mos keqinterpretohet sipas interesave te operatoreve te caktuar ekonomik, mirëpo të Anulohet Vendimi i A.K. për Anulimin e Tenderit.

Pra siq edhe shihet A.K. në mënyre diskriminuese konzorciumin tonë e ka shpallë të papërgjegjëm me arsyetim të pavërtetë dhe jo të bazuar në kriteret e këtij tenderit, dhe ne e kundërshtojmë fuqishëm Vendimin e AK te dates 14.03.2022 per kete tender dhe Vendimin mbi Refuzimin e Kerkeses për Rishqyrtim 18.03.2022.

Gjithashtu ju Sqarojmë se për qështje të njejtë të A.K. Komuna Malishevë , rreth përvojës së inxhinjerit ka dhënë mendim Eksperti i angazhuar nga OSHP-ja me raportin e dates 27.12.2021 dhe për qështjen e njejtë dhe inxhinjerin e njejtë ka vlerësuar se përvoja e inxhinjerit është sipas kërkesave të A.K.

Autoriteti Kontraktues për disa prej projekteve të publikuara kohëve të fundit ka shkelur ligjin e prokurimit , duke paraqitur në Kërkesat e Tenderëve kryesisht për infrastruktur rrugore kushte të pa nevojshme për këto pune ,e duke favorizuar vetëm operator të caktuar ekonomik , kjo vërtetohet nëse shohim në hapjet e tenderëve ku ofertën e tyre kanë paraqitur vetëm një operator ekonomik , dy apo maksimumi tre operator , me këto kërkesa A.K. ka zvogluar në minimum konkurrencën e operatoreve ekonomik , duke vaforizuar vetëm një operator ekonomik . Ne për këtë problem edhe kemi paraqitur disa herë kërkesën për rishqyrtim për eliminimin e këtyre kritereve diskriminuese , mirëpo Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar fare e në këtë mënyrë qëllimisht ka vaforizuar operator të caktuar ekonomik, duke shkelur me të dy këmbët ligjin e prokurimit publik.

Gjithashtu A.K. Komuna e Malishevës (zyra e prokurimit) dy herë ka lejuar kalimin e afatit të vlefshmërisë së tenderit duke mos kërkuar nga Operatoret Ekonomik vazhdimin e vlefshmërisë (konkretisht me datë 27.12.2022 e deri me 06.01.2022 nuk ka pasë vlefshmëri , gjithashtu me datë 08.03.2022 i ka skaduar prap vlefshmëria kurse A.K. në kundërshtim me Nenin 31.4 të RRUOPP-së pa pasur fare vlefshmeri tenderi merr vendime rreth procedurës tenderuese. Ne vullnetarisht kemi njoftuar A.K. se e kemi vazhduar vlefshmërinë e këtij tenderi.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë,
kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

1. APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE „**FLAMURI V**” SHPK (në konzorcium me N.T., „Flamuri” , „Benita Company” shpk)
2. **Te anulohet vendimi i A.K.** për ANULIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT
3. TË KTHEHET TENDERI NË RIVLERËSIM , dhe të shpallet Fitues Grupi i operatoreve „**FLAMURI V**” SHPK (në konzorcium me N.T., „Flamuri” , „Benita Company” shpk) , si Operatori i Përgjegjëm me qmim më të ulët.
4. Të merren masa ndaj zyrtarëve të prokurimit të cilët qëllimisht nuk e zbatojnë ligjin e prokurimit.

Mbetemi me shpresë që Ankesa jonë të shqyrtohet pozitivisht.

Me nderime z.Vllaznim Mazreku (FLAMURI V SHPK)

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t’iu shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

1. Fitimin e humbur
2. Shpenzimet administrative dhe
3. Shpenzimet e pagaditjes së ankesës

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) Një kopje të hapjes së tenderit

- c) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës”*
- d) *një kopje të Kërkeses për Rishqyrtim*
- e) *një kopje të refuzimit të kërkeses sone për rishqyrtim*
- f) *një kopje e Raportit të Ekspertit Shyrtues të datës 27.12.2021 të angazhuar nga OSHP për qështje të ngjashme (rreth përvojës së ingjinerit)*